

PROKURORIA DHE GJYKATA SPECIALE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Analizë e politikave dhe ligjeve rreth ndikimit politik në sistemin e drejtësisë, mungesës së rezultateve në luftimin e kriminalitetit dhe nevojës për krijimin e një Prokurorie dhe Gjykate Speciale me mandat ekskluziv dhe të kufizuar kohor në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në Republikën e Kosovës



Autorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH PROJEKTIT

Instituti i Kosovës për Drejtësi, po zbaton projektin “Fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë”, i cili ka për qëllim që të forcojë sundimin e ligjit, me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe transparencës, duke përfshirë gjyqësi të pavarur efikase dhe efektive. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe National Endowment for Democracy (NED).

Qëndrimet e shprehura në raport janë të autorëve, ato nuk janë domosdoshmërisht qëndrime të donatorëve.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

përkrahur nga:



Gusht 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Problematika në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar	7
3. Legjislacioni dhe mekanizmat për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar	11
4. Vlerësimet vendore për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar	13
5. Vlerësimet ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar	15
6. Rasti i Maqedonisë.....	17
a. Përgjegjësia e udhëheqësit të Prokurorisë Speciale në Maqedoni	20
b. Rezultatet e punës së Prokurorisë Speciale në Maqedoni për një vit	20
7. Mësimet nga Maqedonia.....	21
8. Zgjidhja për Kosovën.....	22
9. Prokuroria dhe Gjykata Speciale për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar	23

1. Përmbledhje ekzekutive

Konteksti

Retorika në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar asnjëherë nuk ka munguar nga të gjithë drejtuesit e institucioneve dhe agjencioneve të pavarura në Republikën e Kosovës. Megjithatë, korrupsioni është endemik dhe Kosova vuan nga mungesa e vullnetit për të luftuar korrupsionin. Vullneti i vetëm për ta luftuar korrupsionin me sukses, kanë mbetur politikat në letër. Për këto politika në letër vazhdimisht janë angazhuar Kuvendi i Kosovës, Qeveria, Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor dhe Policia e Kosovës. Nuk kanë munguar as veprimet procedurale për të ofruar spektakël para qytetarëve dhe faktorit ndërkombëtarë për të krijuar përshtypjen e luftës së vërtetë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Janë ngritur hetime e aktakuza, të cilat rrugës kryesisht dështojnë për shkak të joprofesionalizmit dhe direktivave në trajtimin e rasteve. Korrupsioni që ndiqet kryesisht i takon profilit të ulët, eventualisht të mesëm, të cilat në mbi 60% të aktakuzave dështojnë në gjykata. Gjatë tri viteve të fundit janë ngritur edhe aktakuza të profilit të lartë, të cilat në mbi 90% të rasteve kanë dështuar të provohen. Shumica e tyre kanë dështuar qysh në fazën fillestare. Kjo dëshmon se shumica e këtyre rasteve hetimore apo aktakuzave të ngritura janë iniciuar qëllimisht ose për persekutim ose që ndaj këtyre zyrtarëve të ndërtohet amnisti e përhershme. Gjykatësit, nuk janë duke i trajtuar lëndët e korrupsionit me seriozitet dhe prioritet absolut siç janë shpallur. Vazhdimisht shkelen afatet ligjore, ndërsa në rastet e shqiptimit të dënimeve, gjykatësit janë të mëshirshëm ndaj të korruptuarve, sidomos kur bëhet fjalë për ministra, të cilët edhe pse gjenden fajtorë, dënohen me burgim me kusht.

Përkundër proklamimit të një lufte për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë, rezulton se mungojnë rezultatet për konfiskimin e pasurisë së fituar nga veprat penale të korrupsionit.

Politizimi i skajshëm i institucioneve të pavarura si Policia, sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor, po shërben si mjet i përsosur i kultivimit të kulturës së pandëshkueshmërisë së funksionarëve të lartë shtetërorë, bartësve brenda sistemit prokurorial dhe gjyqësor dhe të njëjtën kohë po shërben për promovimin e këtyre shkelësve të ligjit. Rekrutimi, avancimi dhe përzgjedhja e bartësve të këtyre institucioneve të rëndësishme assesi nuk mund të bëhet pa ndërhyrjen praktike të dorës së politikës, grupeve të interesit brenda dhe jashtë sistemit, e cila përkujdeset që pozitat kyçe të udhëhiqen nga njerëz me integritet të kontestuar dhe tërësisht të dëgjueshëm. Padyshim se në mesin e policëve, prokurorëve dhe gjykatësve ka të atillë me integritet dhe profesionalizëm, të cilët punojnë me ndershmëri, por të cilët nuk vijnë në shprehje brenda këtij sistemi të ndikuar politik.

Republika e Kosovës ka krijuar një legjislacion të përparuar në fushën e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kosova nuk vuan nga mungesa e institucioneve. Në arkitekturën institucionale për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar janë krijuar qëllimisht shumë institucione e agjencione të pavarura në mënyrë që përgjegjësia të shpërndahet dhe askush të mos mbahet përgjegjës për mos luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, gjë që vazhdimisht ndodhë në Kosovë.

Republika e Kosovës prej përfundimit të luftës, sidomos prej shpalljes së pavarësisë ka përfituar me qindra miliona euro ndihmë dhe mbështetje nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian (BE) dhe donator tjerë për të përmirësuar sundimin e ligjit, respektivisht sistemin e drejtësisë në Kosovë. Policë, prokurorë e gjykatës kanë përfituar nga trajnime të specializuara, seminare, punëtori, konferenca vendore dhe ndërkombëtare lidhur me hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Megjithatë, rezultatet konkrete nuk po shihen.

Ndikimi i skajshëm politik dhe mungesa e rezultateve konkrete e kanë cenuar rëndë integritetin e sistemit të drejtësisë, i cili ka ndikuar në humbjen e besimit të publikut dhe qytetarëve, për sundim të ligjit, respektivisht për sistemin e drejtësisë në Kosovë, me të cilin janë të kënaqur vetëm rreth 15 % e qytetarëve.

Për shkak të mos luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar qytetarët e Kosovës mbesin të vetmit në Evropë të izoluar pa të drejtë lëvizje pa viza në shtetet e BE-së.

Zgjidhja për Kosovë

IKD vlerëson se në këtë situatë të krijuar, e cila shpesh shihet e pashpresë, nevojitet krijimi i një Prokurorie dhe Gjykate Speciale, si institucione tërësisht të pavarura, me mandat të kufizuar, me staf të rekrutuar nga bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht SHBA dhe Britania e Madhe. Për më tepër rreth kësaj zgjidhje për Kosovën, IKD ofron modelin e ngjashëm të këtyre institucioneve, për afërsisht sikurse Maqedonia.

Modeli i Maqedonisë dëshmon se në shtete me demokraci të brishtë, ku me vite apo dekada të tëra është instaluar kultura e pandëshkueshmërisë, ndërtimi i rrjetit apo klaneve të interesit në sferën politike, ekonomike, biznesore, nepotizmi, politizimi i institucioneve të pavarura si policia, prokuroria dhe gjykatat, etj, intervenimi dhe ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar është qenësore, përfshirë shprehjen e vullnetit të spektrit të gjerë politik, për depolitizimin e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit.

Respektivisht, intervenimi është parakusht për të ri-vendosur në radhë të parë demokratizimin e vet institucioneve publike dhe shtetërore, dhe qeverisjen e mirë përmes depolitizimit të policisë, prokurorisë dhe gjykatave.

Themelimi i një mekanizmi të ri, tërësisht apolitik edhe në praktikë, duke u bazuar në kriteret e më poshtme, do të ndikonte që në kuadër të sistemit të drejtësisë të instalohet po ashtu parimi i konkurrencës mes institucioneve të hetimit, ndjekjes dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë kontroll dhe mbikëqyrje të këtyre institucioneve.

Për këtë zgjidhje, nevojitet amandamentimi i Kushtetutës lidhur me themelimin e një Prokurorie dhe Gjykate Speciale, duke marr për bazë modalitetin e Maqedonisë. Një marrëveshje e tillë duhet të ketë konsensus dhe përkrahje të plotë të partive më të mëdha politike në Kosovë.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Prokurorie dhe Gjykate Speciale nuk do të ndërhyjnë në asnjë rrethanë në kompetencat dhe përgjegjësitë e Gjykatës Speciale në Hagë të themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

Themelimi i Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale duhet të kufizohet në një kohë të caktuar dhe për vepra penale të caktuara që janë me interes për Shtetin e Kosovës, dhe këto dy institucione duhet të kenë pavarësi të plotë nga institucionet aktuale nga KGJK, KPK, PSh, dhe supremaci ndaj PSRK.

Kompetencat e kësaj prokurorie dhe gjykatë do të jenë vetëm veprat penale që hyjnë në kuadër të këtyre kapitujve: Kapitulli XXIV krimi i organizuar, Kapitulli XXXIV Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe Kapitulli XXXII - Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Prokuroria duhet të ketë të drejtën të marr nën kompetencën e saj në çdo fazë të procedurës, lëndët që kanë filluar apo janë në punë nga prokuroritë themelore apo PSRK.

Prokuroria do të ketë policinë gjyqësore e cila do të veproj ekskluzivisht nën urdhrat e Prokurorisë dhe nuk do të ketë asnjë obligim ligjor ndaj strukturës apo menaxhmentit të Policisë së Kosovës.

IKD beson fuqishëm se krijimi i kësaj Prokurorie dhe Gjykate Speciale nuk do të jetë barrë e buxhetit, sepse këto institucione brenda një periudhe të shkurtë kohore bazuar në rezultatet që pritet të shënojnë, do të nxjerrin shumëfish buxhet më shumë sesa financimi i tyre. Përkundrazi këto institucione do të jenë fitimprurëse për buxhetin e shtetit dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, përmes kthimit të buxhetit në arkën e shtetit, e cila është përfituar përmes aktiviteteve kriminale korruptive.

Parimet për themelimin e Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Themelimi i Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale duhet të bazohet në këto parime: Kriteret dhe procedura të veçanta lidhur me procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë dhe Kryetarit të Gjykatës dhe rekrutimin e prokurorëve dhe gjykatësve;

Verifikimi i së kaluarës së kandidatëve që aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit, kryetarit të gjykatës, prokurorëve dhe gjykatësve, verifikim i cili do të bazohet në standarde ndërkombëtare që sigurojnë verifikimin e potë të integritetit personal dhe profesional të kandidatëve. Çdo prokuror i prokurorisë do të ketë në dispozicion së paku dy ose tre polic hetues që do të punojnë nën urdhra të prokurorit. Policët hetues të caktuar do të kalojnë përmes procesit të verifikimit. Çdo gjykatës do të ketë së paku dy bashkëpunëtor/e profesional dhe një zyrtar ligjor/e.

Procesi i rekrutimit dhe emërimit për prokuror dhe gjykatës të udhëhiqet ekskluzivisht nga faktori ndërkombëtar, respektivisht nga SHBA dhe Britania e Madhe. Prokuroria dhe Gjykata për punën dhe rastet e tyre nuk do të kenë asnjë obligim për të raportuar para KPK, KGJK apo Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;

Juridiksioni kohor i prokurorisë të kufizohet brenda 5 viteve nga themelimi i saj të finalizoj dhe paraqes aktakuzat në gjykatë, me mundësi vazhdimi varësisht prej rezultateve.

Faktori ndërkombëtar në bashkëpunim me partitë politike të caktojnë një komision të përkohshëm i përbërë nga vendor dhe ndërkombëtar, pranë të cilit do të raporton prokuroria dhe gjykata. Raportimi duhet të jetë i rregullt në baza gjashtë mujore dhe vjetore. Raportimi duhet të jetë lidhur me rezultatet. Kuvendi i Kosovës duhet të ndaj buxhet të mjaftueshëm për funksionalizimin e prokurorisë dhe gjykatës. Prokurorët dhe gjykatësit të kenë mbrojtjen adekuate shtetërore në mënyrë që të njëjtit të ushtrjnë kompetencat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur dhe paanshme.

2. Problematika në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar

Retorika në luftimin e korrupsionit asnjëherë nuk ka munguar nga të gjithë drejtuesit e institucioneve dhe agjencioneve të pavarura në Republikën e Kosovës. Megjithatë, korrupsioni është endemik dhe Kosova vuan nga mungesa e vullnetit për të luftuar korrupsionin. Vullneti i vetëm për ta luftuar korrupsionin me sukses, kanë mbetur politikat në letër. Kuvendi i Kosovës, Qeveria, Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor dhe Policia e Kosovës vazhdimisht adresojnë në publik retorikë boshe, duke promovuar politika të fuqishme për luftimin e korrupsionit, ushtrim të kallëzimeve penale deri në ngritje të aktakuzave, por të cilat asnjëherë nuk përfundojnë me rezultate konkrete, respektivisht me aktgjykime dënuese. Përkundër proklamimit të një lufte për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë, rezulton se mungojnë rezultatet për konfiskimin e pasurisë së fituar nga veprat penale të korrupsionit.

Republika e Kosovës prej përfundimit të luftës, sidomos prej shpalljes së pavarësisë ka përfituar me qindra miliona euro ndihmë dhe mbështetje nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian (BE) dhe donator tjerë për të përmirësuar sundimin e ligjit, respektivisht sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Zyrtarët shtetërorë që zbatojnë ligjin në Kosovë kanë përfituar nga trajnime të specializuara, trajnime, seminare, punëtori, konferenca vendore dhe ndërkombëtare lidhur me hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Institucionet që më së shumti kanë përfituar nga partnerët ndërkombëtar, janë Policia e Kosovës, sistemi prokurorial dhe gjyqësor. Numër jashtëzakonisht i madh i zyrtarëve policor, prokurorëve dhe gjykatësve janë trajnuar dhe kanë marrë pjesë në programe të specializuara të organizuara qoftë nga Qeveria e SHBA-së, USAID, Këshilli i Evropës, OSBE, BE-së apo donator të ndryshëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Edhe përkundër investimit, përkrahjes dhe ndihmës që është ofruar nga partnerët ndërkombëtarë në ndërtimin e zhvillimin e institucioneve të pavarura si Policia e Kosovës, Prokurori i Shtetit, Gjykatat, Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor, të njëjtat institucione edhe përkundër asaj se me Kushtetutë dhe Ligj janë të pavarura, në praktikë të njëjtat janë të ndikuara dhe nënshtruara karshi politikës. Raportimi i shkeljeve ligjore nga media, OJQ, qytetarët lidhur me korrupsionin institucional dhe korrupsionin e brendshëm në Polici, sistemin prokurorial dhe gjyqësor gjen zbatim selektiv, e në shumë raste ndjekja penale nuk fillon asnjëherë edhe pse ndodhë para syve të prokurorëve dhe brenda institucionit. Kultura e pandëshkueshmërisë është shndërruar në rregull të pashkruar. Mungesa e kontrollit dhe llogaridhënies, brenda këtyre institucioneve ka krijuar figura të paprekshme ku ligji nuk zbatohet në raport me ta edhe në rastet kur korrupsioni është i dukshëm dhe është e pamundur që i njëjti të fshihet nga mediat dhe publiku.

Politizimi i skajshëm i institucioneve të pavarura si Policia, sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor, po shërben si mjet i përsosur i kultivimit të kulturës së pandëshkueshmërisë së funksionarëve të lartë shtetërorë, bartësve brenda sistemit prokurorial dhe gjyqësor dhe të njëjtën kohë po shërben për promovimin e këtyre shkelësve të ligjit. Rekrutimi, avancimi dhe përzgjedhja e bartësve të këtyre institucioneve të rëndësishme assesi nuk mund të bëhet pa ndërhyrjen praktike të dorës së politikës, grupeve të interesit brenda dhe jashtë sistemit, e cila përkujdeset që pozitat kyçe të udhëhiqen nga njerëz me integritet të kontestuar dhe tërësisht të dëgjueshëm. Padyshim se në mesin e policëve, prokurorëve dhe gjykatësve ka të atillë me integritet dhe profesionalizëm, të cilët punojnë me ndershmëri, por të cilët nuk vijnë në shprehje brenda këtij sistemi të ndikuar politik.

Të njëjtat institucione në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit janë të obliguara që të hetojnë, ndjekin dhe gjykojnë kryesit e veprave penale në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të drejtë. Praktika, e deritanishme ka dëshmuar në dhjetëra apo qindra raste, se këto institucione të drejtësisë zbatojnë drejtësi selektive dhe persekutuese ndaj kundërshtarëve politikë apo të grupeve të ndryshme të interesit. Përderisa, në rastet kur ka dyshim të korrupsionit të nivelit të lartë, Prokuroria dhe

Policia nuk kanë dëshmuar guximin as të fillojnë procedurat penale të hetimit. Rastet me interes publik që përfshihen me miliarda euro dyshime për keqpërdorime, ende mbeten të pashpjeguara për publikun dhe këtu hyn proceset më të rëndësishme në vend si: procesi i privatizimit në përgjithësi, proceset e emërimit të bartësve të institucioneve më të larta në vend, përfshi bartësit e institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë, publikimi i përditshëm i aferave korruptive të zyrtarëve të lartë shtetërore, bartësve të sistemit gjyqësor, prokurorial dhe Policisë së Kosovës, humbja e kontesteve ndërkombëtare në Arbitrazh, emërimet politike në ndërmarrjet publike dhe bordet e pavarura, afera e përgjimeve Pronto, etj.

Në shumë prej këtyre rasteve, Prokurori i Shtetit nuk ka pasur guximin dhe kurajon as të inicioj procedura penale. Për ma tepër në ato raste ku janë iniciuar hetimet, janë mbyllur rastet dhe janë amnistuar zyrtarët e lartë shtetërorë në mënyrë të kundërligjshme, ku në disa raste, prokurorët kanë amnistuar ministrat për korrupsion, me arsyetimin se ata gëzojnë imunitet nga ndjekja penale apo biznese me arsyetimin se kanë gabuar gjatë zbatimi të ligjit.

Ndërsa në ato raste kur këto procedura penale fillojnë, mbi 90 për qind e rasteve dështojnë në fazat e hershme të procedurës penale në shqyrtim fillestar apo në fazat e më vonshme të procedurës penale. Edhe përkundër faktit se në të gjitha raportet vendore dhe ndërkombëtare në mënyrë sistematike konstatohet niveli i lartë i korrupsionit në Kosovë, rezultatet në këtë luftë pothuajse nuk ekzistojnë fare.

Në rastet më serioze të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, afatet ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale shkelen në mënyrë të vazhdueshme. Rasti Stenta, edhe një vit pas ngritjes së aktakuzës, rasti ende është në shqyrtim fillestar. Rasti Ukë Rugova, edhe pse nga ngritja e aktakuzës ka kaluar më shumë se një vit, ky rast ende është në shqyrtim të parë. Kodi i Procedurës Penale përcakton afatin prej 30 ditësh të caktimit dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar nga koha e ngritjes së aktakuzës. Fat të njëjtë kanë edhe rastet ku të përfshirë janë Azem Sylja dhe të tjerët. Që nga tetori i vitit 2016, kur ishte ngritur aktakuza, rasti ende është në fazën fillestare në gjykatë, duke shkelur të gjitha afatet ligjore.

Rasti Naser Osmani dhe të tjerët, që nga 17 mars 2016, kur është mbajtur shqyrtimi fillestar, ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i dytë gjyqësor. Edhe në këtë rasti afati ligjor është shkelur nga ana e gjykatës.

Në të gjitha rastet kur ka pasur aktakuza për pozita të larta si deputet, ministra, kryetar komunash, kryetar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, anëtar të bordeve, familjar të udhëheqësve shtetërore, pothuajse të gjitha njëzëri janë mbyllur dhe personat e akuzuar janë liruar nga përgjegjësia penale.

Mungesës së rezultateve në luftën kundër korrupsionit, gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017 i janë shtuar raportimet për korrupsion të brendshëm në kuadër të Policisë së

Kosovës dhe sistemit prokurorial. Këto institucione që me Kushtetute dhe Ligj janë të mandatuara për të hetuar dhe ndjekur kriminalitetin, fatkeqësisht, të njëjtat bëhen subjekt i shkeljes së ligjit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, respektivisht veprave penale korruptive. Edhe në këto raste mungon ndjekja penale, duke kultivuar më tutje kulturën e pandëshkueshmërisë.

Ndikimi i skajshëm politik dhe mungesa e rezultateve konkrete e kanë cenuar rëndë integritetin e Prokurorit të Shtetit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore. Mungesa e vullnetit dhe guximit të Prokurorit të Shtetit dhe politizimi i skajshëm i këtij institucioni ka ndikuar në humbjen e besimit të publikut dhe qytetarëve, për sundim të ligjit, respektivisht për sistemin e drejtësisë në Kosovë, me të cilin janë të kënaqur vetëm rreth 15 % e qytetarëve.

Niveli i qeverisjes në të gjitha institucionet qendrore, lokale dhe agjenci të pavarura vazhdon të mbetet shqetësues për sa i përket dukurive korruptive. Një numër i madh i këtyre zyrtarëve vazhdojnë të përballen me procedura hetimore dhe gjyqësore. Gjetjet e IKD-së, dëshmojnë se shumica e këtyre rasteve hetimore apo aktakuzave të ngritura janë iniciuar qëllimisht ose për persekutim ose që ndaj këtyre zyrtarëve të ndërtohet amnisti e përhershme. Në këtë drejtim, prokurorët ngritin aktakuza të paqëndrueshme në gjykata për t'i shpallur të pafajshëm të akuzuarit në mënyrë që të njëjtit mos të kenë mundësinë të ndiqen për veprat e njëjta për shkak të parimit res judicata. Njëjtë sikurse lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe qeverisja e mirë në Kosovë, vazhdon të proklamohet përmes retorikës boshe.

Së fundi, më 11 qershor 2017, në Kosovë janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Si rezultat i këtyre zgjedhjeve, Koalicioni PAN (PDK-AAK-NISMA) kishte siguruar 39 vende në Kuvendin e Kosovës. Partia Politike Vetëvendosje kishte fituar 32 deputetë, Koalicioni LDK-AKR-Alternativa ka siguruar 29 deputetë dhe 20 pozita kanë siguruar partitë nga komuniteti jo shumicë në Kosovë.

Pas certifikimit të rezultateve zgjedhore dhe para fillimit të konstituimit të Kuvendit të Kosovës, kishin filluar akuza dhe kundër akuza në mes të partive politike në Kosovë, duke akuzuar persona të caktuar për pjesëmarrje në krim të organizuar, korrupsion, terrorizëm dhe kryerjen veprave penale politike pas luftës. Kjo luftë mediale në mes partive politike tanimë është shndërruar në praktikë pothuajse gjithherë në kohë fushate parazgjedhore dhe konstituimit të institucioneve qendrore në Kosovë.

Partitë politike themelimin e Qeverisë apo fillimin e negociatave për themelimin qeverisë e ndërlikojnë me sqarimin apo tërheqjen e kallëzimeve penale të paraqitura nga subjektet politike kundërshtarë.

Prokurori i Shtetit edhe përkundër obligimit kushtetues dhe ligjor nuk ka ndërmarr masa për të iniciuar procedura penale apo për t'i ftuar këta persona për të dhënë deklaratat dhe për filluar zbardhjen e këtyre rasteve.

Për më tepër, hapat e parë në krijimin e institucioneve publike, me qëllim të qeverisjes së mirë, duken të çuditshëm, duke marrë për bazë se brenda koalicionit PAN dhe LAA ka të akuzuar për korrupsion dhe krim të organizuar. Krerët e këtyre koalicioneve përditë janë parë në publik, duke zhvilluar negociata për krijimin e institucioneve me ish-deputetë gjithashtu të akuzuar për korrupsion dhe krim të organizuar.

Mos luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është një ndër kriteret që nuk është përmbushur nga Kosova lidhur me liberalizimin e vizave. Kosova ende nuk e ka gjetur rrugën për luftimin e këtyre fenomeneve për shkak të kapjes së sistemit të drejtësisë nga politika. Qytetarët e Kosovës janë të vetmit në Evropë që kanë të kufizuar lirinë e lëvizjes në shtetet e BE-së.

3. Legjislacioni dhe mekanizmat për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar

Legjislacioni lidhur me drejtësinë penale i miratuar në Republikën e Kosovës është në harmoni me praktikat dhe standardet ndërkombëtare. Me qëllim të avancimit të këtij legjislacioni, Kosova në vitin 2012, kishte miratuar Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, që kishin hyrë në fuqi me 1 janar 2013. Këto kode kanë zëvendësuar Kodet e Përkohshme Penale që kishin hyrë në fuqi në vitin 2004, në kohën e UNMIK-ut.

Kuvendi i Kosovës në vitin 2013, kishte miratuar edhe Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale. Ky ligj përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale nuk janë të mjaftueshme. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasurinë e fituar nga personat, të cilët kanë kryer vepër penale të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Krahas këtyre ligjeve, Kuvendi i Kosovës në vitin 2010, kishte miratuar edhe Ligjet për Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Gjykatat dhe Prokurorin e Shtetit. Ligjet për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial kishin hyrë në fuqi me 1 janar 2011, kur edhe ishin themeluar këta këshilla si të pavarur, me kompetenca dhe përgjegjësi për të menaxhuar dhe administruar sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Me 1 janar 2011, me qëllim të ofrimit të sigurisë financiare për gjykatësit dhe prokurorët, kishin hyrë në fuqi vetëm dispozitat ligjore të Ligjit për Gjykatat dhe Prokurorin e Shtetit, lidhur me pagat për gjykatës dhe prokurorë. Me këto dispozita

ligjore, pagat e gjykatësve dhe prokurorëve janë rritur në një nivel, i cili është i pranueshëm dhe i dinjitetshëm për realitetin kosovar, gjithnjë duke krahasuar me nivelin e përgjithshëm të pagave në vend.

Më 1 janar 2013, kanë hyrë në fuqi Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit. Me hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve, struktura e gjykatave dhe prokurorive në Kosovë ka ndryshuar, duke themeluar shtatë Gjykata Themelore (shkallë e parë), ku secila gjykatë ka degët e saj, Gjykatën e Apelit (gjykatë e shkallës së dytë) dhe Gjykatën Supreme. E njëjta strukturë ishte zbatuar edhe për Prokurorin e Shtetit, i cili është ndarë në shtatë Prokurori Themelore, Prokuroria e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Përfundimisht, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2007 nga UNMIK-u si Zyrë e Prokurorit Special të Kosovës, në vitin 2008, me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës është themeluar si një organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Kjo prokurori ka mandat dhe juridiksion në tërë territorin e Kosovës, në hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale të përcaktuara me ligj, ku hyn kompetencat e veçanta (ekskluzive) dhe plotësuese.

PSRK ka të drejtë para fillimit të gjykimit kryesor, ka kompetencë që t'i marrë përsipër lëndët që janë në kompetencë të saj të veçantë dhe që janë hetuar a ndjekur penalisht nga organet kompetente në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga viti 2008, PSRK është përbërë nga prokuror vendor dhe prokurorë ndërkombëtar të EULEX-it. Deri në vitin 2014, pozita e Kryeprokurorit të PSRK-së ka qenë e rezervuar për prokurorët ndërkombëtar nga radhët e EULEX-it. Nga prilli i vitit 2014, me miratimin e Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me mandatin të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, është përcaktuar se pozita e Kryeprokurorit të PSRK-së do të ushtrohet nga një prokuror vendor.

Nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka miratuar legjislacion adekuat për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, ka ndër marr reformë në drejtësi për siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë, për të zhvilluar ndjekje penale dhe gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të bazuar në praktikë dhe standardet më të larta ndërkombëtare, përfshirë obligimin për zbatimin e drejtpërdrejtë të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kosova nuk vuan nga mungesa e mekanizmave institucional për luftimin e korrupsionit. Përkundrazi, duke tentuar të proklamojnë luftë kundër korrupsionit, në Kosovë janë krijuar mekanizma të shumtë, me qëllim që të krijohet mjegull dhe askush mos të mbahet përgjegjës për dështime. Në këtë drejtim, Kosova ka ndërtuar këta mekanizma për të hetuar, ndjekur dhe gjykuar kryesit e këtyre veprave penale,

përfshirë, Prokuroritë Themelore, PSRK-në, Policinë, Task forcën policore prej 30 policëve hetues të specializuar në anti-korrupsion, Task forcën kundër korrupsionit në kuadër të PSRK-së, Njësitet për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike brenda Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Korrupsionit të caktuar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Agjencinë Kundër Korrupsionit, Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit të themeluar nga Zyra e Presidentit të Republikës, si një mekanizëm koordinues ndër-institucional.

Edhe përkundër miratimit të kornizës adekuate ligjore dhe ndërtimit të një numri jashtëzakonisht të madh të mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë (EULEX) për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, rezultatet konkrete ende mungojnë. Kosova ende është në kërkim të rrugës për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Këto rezultate kanë ndërtuar si standard kulturën e pandëshkueshmërisë dhe promovimin e shkelësve të ligjit.

4. Vlerësimet vendore për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) nga viti 2013, monitoron në mënyrë sistematike sistemin prokurorial dhe gjyqësor në trajtimin e rasteve të korrupsionit. Të gjeturat e monitorimit të IKD-së konstatojnë se përkundër politikave të miratuara dhe shprehjes së vullnetit deklarativ nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial në luftimin e korrupsionit, rezultatet konkrete në luftimin e tij, veçanërisht të korrupsionit të profilit të lartë ende mungojnë.

Viti 2016 ka vazhduar me spektakle, luftë komunikatash dhe statistikash kundër korrupsionit. Prokurori i Shtetit gjatë këtij viti, në mbi 60% të rasteve të korrupsionit i ka hudhur kallëzimet penale apo i ka pushuar hetimet.

IKD gjatë vitit të kaluar ka monitoruar 1505 seanca gjyqësore në 383 raste të korrupsionit ku kanë qenë të përfshirë 989 të akuzuar, në të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë. Në mbi 60 % të rasteve të korrupsionit, aktakuzat dështojnë në gjykata, duke mos u provuar dhe mbrojtur nga prokurorët. Në rastet e profilit të lartë, kjo përqindje shkon në mbi 90%.



Rastet e profilit të lartë që kanë dështuar në Gjykata

Përpjekjet për luftën kundër korrupsionit përmes aktakuzave, më tepër po dëshmojnë si arsye për publikun dhe faktorin ndërkombëtar se korrupsioni në Kosovë po luftohet. Hulumtimi i IKD-së ka gjetur se në shumë raste të profilit të lartë, prokuroria ka ngritur aktakuzat, të cilat janë hudhur apo refuzuar nga gjykata në raste të caktuara qysh në seancën e shqyrtimit të parë apo edhe në fazat më vonshme të procedurës gjyqësore, si rastet kundër Enver Hasanit, Pal Lekaj, Lutfi Hazirit, Agim Bahtirit, Shpresa Bakisë, etj.

Gjetjet e IKD-së, dëshmojnë se shumica e këtyre rasteve hetimore apo aktakuzave të ngritura janë iniciuar qëllimisht ose për persekutim ose që ndaj këtyre zyrtarëve të ndërtohet amnisti e përhershme. Në këtë drejtim, prokurorët ngritin aktakuzat të paqëndrueshme në gjykata për t'i shpallur të pafajshëm të akuzuarit në mënyrë që të njëjtit mos të kenë mundësinë të ndiqen për veprat e njëjta për shkak të parimit res judicata.

Në rastet kur nuk ka luftim të korrupsionit, atëherë ka promovim. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, prokurorëve të identifikuar si shkelës të ligjit ka vazhduar t'iu ndajë mirënjohje për merita në promovimin e sistemit prokurorial dhe të i ngris në detyrë.

5. Vlerësimet ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar

a) Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2016

Kosova është në fazë të hershme/ka një nivel të përgatitjes në luftimin e korrupsionit. Kosova ka forcuar kapacitetet institucionale për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar me themelimin e ekipeve multi-disiplinare hetimore, krijimin e mekanizmit përcjellës për nivelin e lartë të korrupsionit dhe rastet e krimin të organizuar si dhe forcimin e Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të lëndëve të hetuara dhe të ndjekura penalisht. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Vullneti më i fortë politik është i nevojshëm për t'a trajtuar këtë çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Kosova është në fazë të hershme të luftimit të krimin të organizuar. Numri i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare mbetet i ulët. Mangësitë e legjislacionit ekzistojnë ende dhe zbatimi duhet të përmirësohet në veçanti rreth çështjes së shpërlarjes së parave, konfiskimit dhe sekuestrimit të aseteve dhe hetimit financiar. Ndikimi i tepruar gjatë hetimeve dhe mungesa e angazhimit strategjik politik pengojnë luftën kundër krimin të organizuar. Kosova ka vazhduar me përpjekjet e saj për të luftuar terrorizmin por ende përballet me sfida në këtë fushë.

Kosova gjendet në fazë fillestare/në nivel të përgatitjeve në luftën kundër korrupsionit. Progres është arritur gjatë vitit të kaluar. Me themelimin e ekipeve multi-disiplinare hetimore, krijimin e mekanizmit të gjurmimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar, Kosova ka përmbushur dy rekomandimet e vitit të kaluar. Kjo ka çuar në rritjen e numrit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë të cilat janë hetuar dhe ndjekur penalisht. Megjithatë, Kosova duhet të vazhdojë forcimin e gjurmimit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz. Vullneti politik për të trajtuar këtë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike duhet të përmirësohet. Efikasiteti i hetimeve vazhdon të pengohet nga ndikimi politik.

b) Raporti i Progresit për vitin 2015

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjeve në luftimin e korrupsionit. Është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike për të siguruar rezultate reale në luftimin e korrupsionit endemik në Kosovë. Mbetet të krijohet një sistem regjistrimi për rastet e suksesshme të ndjekjes dhe dënimit. Hetimet e rralla të korrupsionit në nivelin e lartë, deri më tash nuk kanë rezultuar me dënime.

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjeve në luftimin e krimin të organizuar. Është shënuar pak progres në bashkëpunimin ndër-institucional dhe në

shkëmbimin e informatave ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit lidhur me hetimet. Megjithatë, numri i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare ende mbetet i ulët. Masa e konfiskimit të pasurive aplikohet rrallë. Përqendrimi në strategjitë dhe planet e veprimit nuk duhet të vë në hije nevojën për rezultate të vërteta në luftimin e krimit të organizuar endemik në Kosovë. Kosova ka rritur përpjekjet e saj për luftimin e terrorizmit, mirëpo ajo ende vazhdon të ballafaqohet me sfida që ndërliken me radikalizmin.

Kosova është në një fazë të hershme të luftimit të korrupsionit. Pak përparim është bërë gjatë vitit të kaluar, veçanërisht në përmirësimin e bashkëpunimit në mes të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Prokurorisë, dhe për të kërkuar nga zyrtarët që të deklarojnë pronën dhe dhuratat. Megjithatë, progresi i përgjithshëm ka qenë i kufizuar dhe në këtë drejtim nevojitet vullnet dhe angazhim politik i fuqishëm për trajtimin e këtij fenomeni në mënyrë të duhur. Një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike është e nevojshme për të siguruar rezultate të vërteta në luftimin e korrupsionit endemik në Kosovë. Regjistrimi i përndjekjeve dhe dënimeve të suksesshme do të paraqiste një progres të vërtetë.

c) Raporti i Progresit për vitin 2014

Kosova ka bërë progres të kufizuar dhe është në një fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit. Edhe pse Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës ka priorizuar rastet e korrupsionit, nuk ka asnjë evidencë për ndonjë dënim. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha, duke përfshirë prokurimin publik, dhe vazhdon të jetë një problem serioz që duhet të adresohet urgjentisht. Nevojitet angazhim i shtuar politik për të shndërruar përpjekjet në rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit. Po ashtu duhet të ketë fuqizohet bashkëpunimi ndër-institucional. Gjyqësorit duhet t'i krijohet mundësia që të luftoj këtë fenomen në mënyrë efektive. Në të njëjtën kohë prokurorët dhe gjyqtarët duhet të tregojnë më shumë përgjegjshmëri duke i trajtuar rastet në mënyrë më efikase dhe duke dhënë rezultate. Lufta kundër krimit të organizuar Kosova ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar luftën kundër krimit të organizuar. Ajo ka vazhduar të përmirësoj kornizën e saj legjislativ, posaçërisht duke miratuar legjislacionin zbatues për pastrimin e parave. Kapacitetet hetimore të policisë në përgjithësi janë të mira. Bashkëpunimi me EULEX-in është intensifikuar dhe është vlerësuar si shumë i mirë. Numri i hetimeve të krimeve të lidhura me drogën ka shënuar rritje dhe disa grupe të trafikut njerëzor janë shpërbërë. Kosova është në një fazë të hershme të arritjes së rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar, i cili vazhdon të jetë një sfidë serioze

d) Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan për të Drejtat e Njeriut për vitin 2016 për Kosovë

Korrupsioni endemik në sektorin qeveritar dhe në atë privat dhe mungesa e ndëshkimit për vepra të korrupsionit mbeti shqetësim i rëndësishëm i të drejtave të njeriut.

Qeveria ndërmori masa për t'i ndjekur penalisht dhe dënuar zyrtarët që kryen abuzime në shërbime të sigurisë apo gjetiu në Qeveri. Shumë veta në opozitë, shoqëri civile dhe media mendonin që zyrtarët e lartë përfshiheshin në korrupsion pa u ndëshkuar.

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion nga zyrtarët, por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efikase dhe korrupsioni mbeti problem serioz. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan këtij problemi.

Raportet e Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut për vitet 2015 dhe 2014, janë pothuajse të njëjta, ku theksohet korrupsioni endemik në qeveri, kultura e pandëshkueshmërisë dhe mungesa e rezultateve në luftimin e korrupsionit.

6. Rasti i Maqedonisë

Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Maqedoninë për vitin 2016, ndër të tjera ka konstatuar se ky shtet në luftën kundër korrupsionit ka një nivel të përgatitjes (fazë fillestare). Korniza institucionale dhe legjislative është ndërtuar gjatë dekadës së fundit.. Korrupsioni mbetet problem kyç në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem serioz. Ndërhyrjet politike në trajtimin e lëndëve të korrupsionit janë evidente. Veçanërisht në rastet e nivelit të lartë.

Në shtator të vitit 2015, Maqedonia ka themeluar Prokurorin Publik (*në vazhdim: Prokuroria Speciale*)¹, me mandat dhe kompetencë në ndjekjen penale të dyshimeve të paraqitura në publik lidhur me keqpërdorimin e detyrës zyrtare.² Themelimit të kësaj prokurorie i kishte paraprirë publikimi i përmbajtjes së incizimeve të paligjshme në fillim të vitit 2015, nga lideri i opozitës në Maqedoni aso kohe Zoran Zaev, aktualisht, Kryeministër i Maqedonisë. Opozita në Maqedoni përmes publikimit të këtyre përgjimeve ka zbuluar se Qeveria e Maqedonisë, ka spiunuar me dhjetëra mijëra qytetarë të saj pa vendime gjyqësore.

¹ *Shënim:* Emërtimi i kësaj Prokurorie, është bërë njëjtë sikurse emërtimi i Prokurorit Publik në fuqi. Prandaj, për të pasur më të qartë se në këtë punim flitet për Prokurorin e ri Publik, në vazhdim të punimit, do të referohet si Prokuroria Speciale në vend të Prokurorit Publik.

² Ligji Nr. 159 për Prokurori Publike për ndjekjen e veprave penale të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve. Miratuar me 15 shtator 2015. (Shih linkun <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/926832067f424aa58316bdc8d5809295.pdf>)

Publikimi i përgjimeve ka shkaktuar në Maqedoni protesta në mes të përkrahësve të opozitës dhe pozitës. Ndarjet e mëdha në mes të pozitës dhe opozitës në Maqedoni janë tejkaluara pas negociatave politike të ndërmjetësuara nga Ambasadori Amerikan në Maqedoni, Jess Baily dhe Komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerim, Johannes Hahn. Si rezultat i këtyre negociatave është arritur marrëveshja për themelimin e Prokurorisë Speciale, ku pëlqimin e kanë dhënë partitë politike më të mëdha në Maqedoni.

Themelimit të Prokurorisë Speciale i ka paraprirë po ashtu perceptimi i përgjithshëm i publikut se në Maqedoni gjyqësori, prokuroria dhe policia janë të ndikuara nga politika, dhe se prokuroria nuk ka vullnet dhe gatishmëri të hetojë dhe ndjek penalisht zyrtarët e lartë shtetërorë.

Negociatat për themelimin e Prokurorisë Speciale janë udhëhequr përmes negociatave politike në mes të partive politike më të mëdha në Maqedoni dhe të ndërmjetësuar nga ndërmjetësuari special Peter Vanhoutte. Qëllimi i këtyre negociatave ishte themelimi i kësaj Prokurorie Speciale, e cila do të ishte politikisht e pavarur dhe profesionale në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të përcaktuara me ligj.

Në këtë drejtim partitë politike dhe faktori ndërkombëtar i përfshirë në këtë proces, për të arritur këtë qëllim, ishte fokusuar në dy drejtime, hartimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale përfshirë: mandatin e kësaj prokurorie, mënyrën e zgjedhjes së prokurorëve special, raportimit të kësaj prokurorie, identifikimi dhe zgjedhja e prokurorëve special me integritet dhe përvojë profesionale adekuate.

Miratimi i këtij ligji nga Kuvendi i Maqedonisë ka përcaktuar se Prokuroria Speciale nuk është kategori kushtetuese. Kushtetuta³, Ligji për Prokurorin Publik⁴ dhe Ligji për Këshillin e Prokurorëve Publik në Maqedoni përcaktojnë procedurat dhe rregullat lidhur me procesin e propozimit, dhe emërimit të prokurorit publik.⁵ Me qëllim të sigurimit të pavarësisë së Prokurorisë Speciale, procesi i emërimit të prokurorëve special është rregulluar në mënyrë tjetër. Neni 3 i Ligjit për Prokurorinë Speciale për ndjekjen e veprave penale, të cilat kanë të bëjnë dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve (Ligji) ka përcaktuar se zgjedhja

³ Neni 126 i Kushtetutës së Maqedonisë, në:

http://www.siofa.gov.mk/data/file/ustav_ustavni_amandmani_al.pdf

⁴ Neni 40 dhe 41 i Ligjit për Prokurorin Publik, gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 150, datës 12.12.2007, në: http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/Javnoto_obvinitelstvo_150_12122007.pdf

Ligji për ndryshimin e ligjit për Prokurorin Publik, gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 111, datës 3 shtator 2008, në:

http://jorm.gov.mk/wp-content/uploads/2016/03/I_Zakon_za_Javno_obvinitelstvo_111_03092008.pdf

⁵ Shënim: Sipas Ligjit mbi Prokurorinë publike, Prokuroria publike në Maqedoni është e organizuar në këto nivele:

Prokurori Themelor; Prokurori i Lartë dhe Prokurori Publik. Prokurori Themelor vepron para Gjykatës Themelore, Prokurori i Lartë para Gjykatës së Apelit dhe Prokurori Publik i R.M. para Gjykatës Supreme të Maqedonisë.

e prokurorëve special do të bëhet me propozim të Komisionit për Çështje Zgjedhjeve, me pëlqim paraprak të katër partive politike me numrin më të madh të deputetëve në Kuvendin e Maqedonisë.

Ky ligj përcakton po ashtu, se me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, me pëlqim paraprak të katër partive politike me numrin më të madh të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Këshilli me propozim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, pa shpallje të konkursit publik, e zgjedh Prokurorin Publik, me mandat prej 4 vjetëve me të drejtë të rizgjedhjes.

Kuvendi do ta përcaktojë kandidatin për Prokuror Special me shumicën e dy të tretave, duke përfshirë edhe shumicën e votave të deputetëve, të cilët u takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë, dhe do ta dorëzojë në Këshillin e Prokurorëve Publik të Republikës së Maqedonisë ("Këshilli"). Këshilli do ta zgjedhë Prokurorin Special në seancë në të cilën janë të pranishëm së paku 2/3 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Rëndësi për të siguruar pavarësinë e kësaj prokurorie i është kushtuar autonomisë së Prokurorit Special, i cili udhëheq me Prokurorinë Speciale. Ligji ka paraparë se me punën e Prokurorisë Speciale në mënyrë të pavarur udhëheq Prokurori Special, i cili i sistemon punët dhe detyrat e punës si dhe përgjigjet për kryerjen në kohë dhe në mënyrë kualitative të punëve në prokurori.⁶

Prokurori Special ka autonomi të plotë në hetimin dhe përndjekjen e veprave penale që kanë të bëjnë me dhe që rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paautorizuar të komunikimeve. Asnjë prokuror publik i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë, duke i përfshirë edhe Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë, nuk mund të ndikojë në punën e tij, ose të kërkojë raporte lidhur me lëndët e Prokurorit Special ose prokurorëve special në kuadër të Prokurorisë Speciale.

Në kolegjiomet në përbërje të zgjeruar në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë nuk thirret dhe nuk është i pranishëm Prokurori Special dhe prokurorët special të Prokurorisë Speciale dhe nuk shqyrtohen çështjet që janë në kompetencë të Prokurorisë Speciale. Prokurori më i lartë publik nuk mund të ngrejë iniciativë as kërkesë për referim në lëndë të caktuar ose ngjarje juridike penale të Prokurorisë Speciale. Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë ose prokurori tjetër publik nuk mund të ndërmarrin hetime dhe përndjekje për lëndë, të cilat janë në kompetencë të Prokurorisë Speciale ose pëlqim me shkrim të tij/saj.

⁶ Neni 6 paragrafi 1.

a. Përgjegjësia e udhëheqësit të Prokurorisë Speciale në Maqedoni

Prokurori Special do të jetë përgjegjës për punën e tij/saj para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë. Prokurori Publik do të parashtojë raport çdo gjashtë muaj për aktivitetet e tij/saj, duke përfshirë edhe përshkrimin për progres në cilindo hetim ose përndjekje të ndërmarrë nga Prokurori Special. Në raportin e tillë mund të anashkalohen materiale, të cilat sipas Prokurorit Special duhet të ruhen si konfidenciale, por do të sigurojë informata përkatëse që t'i arsyetojë shpenzimet. Prokurori Special do të jetë përgjegjës profesionalisht për veprimet profesionale dhe ligjore gjatë punës së tij/saj para Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Pas miratimit të Ligjit, me 15 shtator 2015, Këshilli Prokurorëve Publik të Maqedonisë kishte zgjedhur Katica Janeva si Prokurore Speciale. Në fillim të tetorit 2015, i njëjti Këshill kishte zgjedhur pesë prokuror special të propozuar nga Prokurorja Speciale Janeva, përderisa më 5 nëntor 2015, i njëjti Këshill sipas propozimit të Prokurores Speciale kishte zgjedhur edhe shtatë prokurorë special të rinj, duke dërguar numrin në total prej 12 prokurorë në Prokurorinë Speciale.

b. Rezultatet e punës së Prokurorisë Speciale në Maqedoni për një vit

Më 29 qershor 2017, në konferencën për media, Prokurorja Speciale e Maqedonisë, Katica Janeva, ka njoftuar lidhur me dorëzimin në gjykatë të 17 aktakuzave të reja, kundër 94 personave fizikë dhe 7 persona juridikë, krahas tri akuzave të ngritura paraprakisht. "Prokuroria Speciale është duke punuar për vetëm 10 muaj. Aktakuzat janë rezultat i punës së ekipit të Prokurorisë Speciale për të krijuar kushtet për sundim të drejtësisë dhe sigurimit të barazisë së qytetarëve të Maqedonisë para ligjit dhe Kushtetutës". "Dita e sotme e as 1 korriku nuk ndryshon asgjë që ky institucion të vazhdojë punën e tij. Ky institucion do të vazhdojë të zbardhë drejtësinë", kishte deklaruar para gazetarëve Janeva.

Prokuroria Speciale e Maqedonisë po ashtu kishte kërkuar caktimin e masës së paraburgimit për 18 të akuzuar, në mesin e të cilëve janë edhe ish-kryeministri i Maqedonisë Nikolla Gruevski, shefi i kabinetit të tij, Martin Protugerin, ish-sekretari i përgjithshëm i Qeverisë, Kiril Bozhinovski, si dhe ish-ministrat Mile Janakieskin, Gordana Jankulloska dhe Elizabeta Kamceska. Po ashtu ishte kërkuar paraburgim edhe për ish-zyrtarë të lartë të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, si dhe drejtues të komunave. Gjykata në këto raste, kishte caktuar masën e arrestit shtëpiak për zyrtarët e lartshënuar, duke përfshirë edhe sequestrimin e pasaportave.

Ish-kryeministri dhe kreu aktual i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski akuzohet nga Prokuroria Speciale për 4 çështje të ndryshme, përfshi rastin "Titanik" për shpërdorime zgjedhore; rastin "TNT" për rrënimin e objektit të "Fiat Canovskit-Kosomos"; rastin "Trajektorja" për ndërtimin e autostradave; si dhe rastin "Tanku",

për furnizimin e Mercedesit me 580 mijë euro. Ish-Kryeministri Gruevski po ashtu është duke u hetuar nga Prokuroria Speciale edhe për shpërlarje të parasë në vlerë prej dhjetëra miliona eurove.

Prokuroria Speciale e Maqedonisë e ka thyer mitin se në këtë shtet ka persona të paprekshëm dhe ka ndryshuar kulturën e pandëshkueshmërisë, për një kohë të shkurtër prej 12 – 18 muaj, duke shënuar rezultate përmes luftës efikase dhe efektive, duke ushtruar funksionet në mënyrë të pavarur dhe pa ndikim nga politika.

Rrjeti politik i ndërtuar për vite dhe dekada të tëra në këtë shtet, i cili ka arritur që të ketë kontroll të përgjithshëm dhe të ushtroj ndikimin mbi policinë, prokurorinë, gjykatat, ekonominë, bizneset dhe fushat tjera me interes, është shpartalluar dhe pothuajse udhëheqësit kryesorë në këtë shtet tanimë janë subjekt i hetimit dhe ndjekjes penale nga ana e Prokurorisë Speciale.

Ndërkohë, ka filluar depolitizimi dhe dekriminalizimi i sistemit të drejtësisë. Në vitin 2017, pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, me qëllim të depolitizimit të Prokurorit Publik të Maqedonisë ky shtet ka filluar procedurat për shkarkimin e prokurorit publik aktual, Marko Zvrlevski ⁷, i cili kishte shërbyer si piun i pushtetit, duke mos i zbatuar obligimet kushtetuese dhe ligjore për të ndjekur kryesit e pushtetshëm të veprave penale. Kuvendi i Maqedonisë më 17 gusht 2017, me 64 vota pro dhe asnjë kundër kishte shkarkuar Prokurorin Publik të Maqedonisë.⁸

Partia politike më e madhe në Maqedoni pas shkarkimit të Prokurorit Publik kishte deklaruar se “me shkarkimin e prokurorit fillojnë reformat në drejtësi”.

Shkarkimin e Zvrlevskit, LSDM-ja e cilësoi si hap i parë drejtë reformave në sistemin gjyqësor. Petre Shilegov tha se prokurori i ri shtetëror do të zgjidhet në bazë të kriterëve profesionale dhe jo në bazë të lidhjeve partiake. “Shkarkimi i Marko Zvrlevskit e shënon fillimin e reformave në gjyqësor, të cilat do të sjellin drejtësi për të gjithë. Ky është hapi i parë i fillimit të funksionimit të një sistemi të pavarur dhe profesional gjyqësor. Procedura për rizgjedhjen e prokurorit të ri, mesa di unë, duhet të fillojë, por megjithatë në bazë të procedurave nuk besoj se mund të arrijmë ta zgjedhim para zgjedhjeve lokale”.

7. Mësimet nga Maqedonia

Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë si në Maqedoni ashtu dhe në Kosovë, ka qenë dhe mbetet kërkesë e faktorit ndërkombëtar si

⁷ “Marko Zvrlevski: Macedonia’s ‘Puppet’ Prosecutor Faces Dismissal” – “Marko Zvrlevski:Prokurori “piun” i Maqedonisë ballafaqohet me shkarkim”. Balkaninsight.com 8 janar 2017. (Shih linkun <http://www.balkaninsight.com/en/article/marko-zvrlevski-macedonia-s-puppet-prosecutor-faces-dismissal-06-07-2017-1>)

⁸ <http://ina-online.net/lajmi-fundit-64-vota-pro-dhe-asnje-kunder-shkarkohet-kryeprokurori-zverlevski/>

parakusht për integrim në Bashkimin Evropian. Kosova në vitin 2016 ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim Associm (MSA) me Bashkimin Evropian. Kurse, MSA mes BE-së dhe Maqedonisë kishte hyrë në fuqi në vitin 2004. Në vitin 2005, Këshilli i Evropës i kishte lejuar Maqedonisë statusin e kandidatit. Në vitin 2009, Komisioni Evropian i kishte rekomanduar Këshillit Evropian të hap negociatat për pranim të Maqedonisë. Maqedonia kishte ngecur në rrugën e saj drejt integritit evropian, përderisa në vitin 2015, Komisioni Evropian kishte deklaruar se ishte i gatshëm të zgjeroj rekomandimin për hapjen e negociatave për pranim me kusht që Marrëveshja e Przhinos të zbatohet dhe të ketë progres substancial në zbatimin e reformës me prioritet urgjent të miratuara në vitin 2015.

Reformat me prioritet urgjent ishin kërkesa të caktuara nga Komisioni Evropian për Maqedoninë, ku kërkohet që ky shtet të ndërmarr hapa urgjent në adresimin e çështjeve që hyn në kuadër të sundimit të ligjit dhe respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Ndër çështjet më me prioritet, përfshihej depolitizimi i procesit të emërimit dhe ngritjes në detyrë të prokurorëve dhe gjykatësve në Maqedoni, disiplinimi dhe shkarkimi i gjykatësve që ndërhyjnë në pavarësinë e gjyqësorit, për të siguruar profesionalizmin e Këshillit Gjyqësor në praktikë dhe jo vetëm në teori, dhe çështje tjera që do të siguronin edhe në praktikë pavarësinë e gjykatësve dhe prokurorëve në Maqedoni.

Përderisa, Maqedonia ka përfituar nga liberalizimi i vizave, Kosova ende mbetet vendi i fundit në Evropë që ende nuk ka plotësuar kriteret për të përfituar lëvizjen e lirë të qytetarëve të saj në Bashkimin Evropian. Ende si kriter mbetet luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe ratifikimi i Marrëveshjes për Demarkacion me Malin e Zi.

8. Zgjidhja për Kosovën

Edhe përkundër se PSRK në Kosovë vepron prej vitit 2008, kjo prokurori nuk ka dëshmuar se është e gatshme dhe ka vullnet për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë e saj në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit.

Që nga viti 2008 deri në vitin 2014, prokurorët ndërkombëtar të EULEX-it në PSRK kishin mandat ekskluziv në trajtimin e rasteve më të ndërlikuara dhe komplekse në Kosovë. Edhe përkundër kësaj, Kosova edhe në vitin 2017, është sinonim i një shteti ku mungon sundimi i ligjit, dhe ku kultura e pandëshkueshmërisë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë edhe standard jetese. Të korruptuarit dhe shkelësit e ligjit vazhdimisht promovohen dhe janë shndërruar në “model të suksesit” për arritje në Kosovë.

Nga viti 2014, kompetencat e rezervuara për EULEX-in në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve më të rënda, ndërlikuara dhe komplekse në Kosovë janë transferuar tek prokurorët dhe gjykatësit vendor, përveç rasteve që kanë pasur në punë prokurorët

dhe gjykatësit ndërkombëtar të EULEX-it para vitit 2014. Përbashtimisht, prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtar të EULEX-it edhe në vitin 2017, mund të marrin raste të reja në punë, në rrethana të jashtëzakonshme, që në praktikë ndodh shumë rrallë.

Që nga transferimi i kompetencave tek vendorët në vitin 2014, në Kosovë janë raportuar dyshime për vepra penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë. Në rastet kur janë të përfshirë, figura të larta politike, grupe të interesit, apo njerëz nga grupe të fuqishme të biznesit, Prokuroria nuk ka pasur vullnet dhe nuk ka gjetur guximin për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore për të iniciuar procedura penale në këto raste.

Raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare që monitorojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë, në mënyrë të vazhdueshme kanë raportuar për politizim të skajshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë. Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, Raportet e Departamentit të Shtetit Amerikan, konkluzionet e nëngrupeve të takimeve lidhur me MSA mes Komisionit Evropian dhe Kosovës konstatojnë mungesën e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë në Kosovë, politizimin e institucioneve të pavarura, përfshirë sistemin e drejtësisë, instalimin e kulturës së pandëshkueshmërisë, etj.

Publiku në Kosovë, media, OJQ-të, qytetarët, shërbyesit civil, administrata shtetërore në ato raste kur ballafaqohen me dukuritë e korrupsionit në Kosovë nuk kanë një adresë të besueshme për të raportuar të njëjtat. Instalimi i kulturës së pandëshkueshmërisë ka rritur mungesën e besimit që këto dukuri t'i raportojnë tek institucionet kompetente që këto raste t'i trajtojnë në mënyrë të pavarur, paanshme dhe profesionalisht.

IKD vlerëson se në këtë situatë të krijuar, e cila shpesh shihet e pashpresë, nevojitet krijimi i një Prokurorie dhe Gjykate Speciale, si institucione tërësisht të pavarura, me mandat të kufizuar, me staf të rekrutuar nga bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht SHBA dhe Britania e Madhe. Për më tepër rreth kësaj zgjidhje për Kosovën, IKD ofron modelin e ngjashëm të këtyre institucioneve, sikurse Maqedonia.

9. Prokuroria dhe Gjykata Speciale për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar

Modeli i Maqedonisë dëshmon se në shtete me demokraci të brishtë, ku me vite apo dekada të tëra është instaluar kultura e pandëshkueshmërisë, ndërtimi i rrjetit apo klaneve të interesit në sferën politike, ekonomike, biznesore, nepotizmi, politizimi i institucioneve të pavarura si policia, prokuroria dhe gjykatat, etj, intervenimi dhe ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar është qenësore, përfshirë shprehjen e vullnetit të spektrit të gjerë politik, për depolitizimin e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit.

Respektivisht, intervenimi është parakusht për të ri-vendosur në radhë të parë demokratizimin e vet institucioneve publike dhe shtetërore, dhe qeverisjen e mirë përmes depolitizimit të policisë, prokurorisë dhe gjykatave.

Në këtë drejtim, IKD por edhe faktori ndërkombëtar në Kosovë tanimë është i bindur për bazë mungesën e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndërhyrjet e vazhdueshme të politikës në punën e pavarur të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, mungesën e vullnetit dhe guximit të policisë dhe prokurorisë në trajtimin e lëndëve të korrupsionit të lartë kur prekën interesat e pushtetit politik, politizimin e institucioneve të pavarura, skandalet në Policinë e Kosovës, sistemin prokurorial dhe gjyqësor.

IKD si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit sistematik të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar ka gjetur se mekanizmat aktual të hetimit, ndjekjes dhe gjykimit nuk janë efikas, të pavarur dhe profesional në trajtimin e këtyre çështjeve.

Themelimi i një mekanizmi të ri, duke u bazuar në kriteret e më poshtme, do të ndikonte që në kuadër të sistemit të drejtësisë të instalohet po ashtu parimi i konkurrencës mes institucioneve të hetimit, ndjekjes dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë kontroll dhe mbikëqyrje të këtyre institucioneve.

Në këtë drejtim IKD, rekomandon:

Me mbështetjen e faktorit ndërkombëtar të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, ndihmuar nga Bashkimi Evropian të hapet debat publik që legjislatura dhe qeveria e ardhshme e Kosovës të ketë prioritet sundimin e ligjit në Kosovë.

Të shqyrtohet dhe zbatohet në praktikë, amandamentimi i Kushtetutës lidhur me themelimin e një Prokurorie dhe Gjykate Speciale, duke marr për bazë modalitetin e Maqedonisë. Një marrëveshje e tillë duhet të ketë konsensus dhe përkrahje të plotë të partive më të mëdha politike në Kosovë.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e kësaj Prokurorie dhe Gjykate Speciale nuk do të ndërhyjnë në asnjë rrethanë në kompetencat dhe përgjegjësitë e Gjykatës Speciale në Hagë të themeluar nga Kuvendi i Kosovës.

Themelimi i Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale duhet të kufizohet në një kohë të caktuar dhe për vepra penale të caktuara që janë me interes për Shtetin e Kosovës, dhe këto dy institucione duhet të kenë pavarësi të plotë nga institucionet aktuale nga KGJK, KPK, PSh, dhe supremaci ndaj PSRK.

IKD beson fuqishëm se krijimi i kësaj Prokurorie dhe Gjykate Speciale nuk do të jetë barrë e buxhetit, sepse këto institucione brenda një periudhe të shkurtë kohore bazuar në rezultatet që pritet të shënojnë, do të nxjerrin shumëfish buxhet më shumë

sesa financimi i tyre. Përkundrazi këto institucione do të jenë fitimprurëse për buxhetin e shtetit dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, përmes kthimit të buxhetit në arkën e shtetit, e cila është përfituar përmes aktiviteteve kriminale korruptive.

Kompetencat e Prokurorisë dhe Gjykatës:

Kompetencat e kësaj prokurorie dhe gjykatë do të jenë vetëm veprat penale që hyjnë në kuadër të kapitujve të më poshtëm:

- Kapitulli XXIV Krimi i organizuar,
- Kapitulli XXXIV Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare,
- Kapitulli XXXII Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Prokuroria duhet të ketë të drejtën të marr nën kompetencën e saj në çdo fazë të procedurës, lëndët që kanë filluar apo janë në punë nga prokuroritë themelore apo PSRK.

Prokuroria do të ketë policinë gjyqësore e cila do të veproj ekskluzivisht nën urdhrat e Prokurorisë dhe nuk do të ketë asnjë obligim ligjor ndaj strukturës apo menaxhmentit të Policisë së Kosovës.

Themelimi i Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale duhet të bazohet në parimet e mëposhtme:

Kritere dhe procedura të veçanta lidhur me procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë dhe Kryetarit të Gjykatës;

Kritere dhe procedura të veçanta lidhur me rekrutimin e prokurorëve dhe gjykatësve;

Verifikimi i së kaluarës së kandidatëve që aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit, kryetarit të gjykatës, prokurorëve dhe gjykatësve;

Verifikimi i së kaluarës do të bazohet në standarde ndërkombëtare që sigurojnë verifikimin e potë të integritetit personal dhe profesional të kandidatëve,

Çdo prokuror i prokurorisë do të ketë në dispozicion së paku dy ose tre polic hetues që do të punojnë nën urdhra të prokurorit;

Policët hetues të caktuar do të kalojnë përmes procesit të verifikimit;

Çdo gjykatës do të ketë së paku dy bashkëpunëtor/e profesional dhe një zyrtar ligjor/e;

Procesi i rekrutimit dhe emërimit për prokuror dhe gjykatës të udhëhiqet ekskluzivisht nga faktori ndërkombëtar, respektivisht nga SHBA dhe Britania e Madhe.

Prokuroria dhe Gjykata për punën dhe rastet e tyre nuk do të kenë asnjë obligim për të raportuar para KPK, KGJK apo Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;

Juridiksioni kohor i prokurorisë të kufizohet brenda 5 viteve nga themelimi i saj të finalizoj dhe paraqes aktakuzat në gjykatë, me mundësi vazhdimi varësisht prej rezultateve.

Faktori ndërkombëtar në bashkëpunim me partitë politike të caktojnë një komision të përkohshëm i përbërë nga vendor dhe ndërkombëtar, pranë të cilit do të raporton prokuroria dhe gjykata. Raportimi duhet të jetë i rregullt në baza gjashtë mujore dhe vjetore. Raportimi duhet të jetë lidhur me rezultatet.

Kuvendi i Kosovës të ndaj buxhet të mjaftueshëm për funksionalizimin e prokurorisë dhe gjykatës.

Prokurorët dhe gjykatësit të kenë mbrojtjen adekuate shtetërore në mënyrë që të njëjtit të ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur dhe paanshme.

IKD në tabelën më poshtë rekomandon edhe përbërjen e Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale.

PËRBËRJA E PROKURORISË DHE GJYKATËS SPECIALE	
Pozita	Numri
Prokuror në Prokurorinë Speciale	10
Staf mbështetës	30
Prokuror Special në Prokurorinë e Apelit	3
Staf mbështetës	9
Gjykatës në Gjykatën Speciale	18
Staf mbështetës	36
Gjykatës në Gjykatën Speciale të Apelit	6
Staf mbështetës	18
Polic gjyqësor (hetues i policisë)	30